




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, duke u mbështetur në nenin 4 paragrafi 3.1 dhe nenin 16 të Ligjit Nr. 05/L-042 “Për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit”, si dhe në nenin 4, nenin 9 dhe nenin 11 të Rregullores Nr. 16/2025 Për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 28/01, datë 22.01.2026 të KRU “Gjakova” Sh.A., për ndryshimin dhe plotësimin e licencës së shërbimit përmes shtimit të kategorive të reja të shërbimeve, me datën 22.01.2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Licencës së Shërbimit L-04/2018, të KRU “Gjakova” Sh.A.

1. Miratohet kërkesa e KRU “Gjakova” Sh.A., me seli në Gjakovë, për ndryshimin dhe plotësimin e licencës ekzistuese të shërbimit, përmes shtimit të kategorive:
 - 1.1. Kategorija C – Shërbimet e Ujërave të Ndotura dhe
 - 1.2. Kategorija E – Shërbimet e Ujit të Përpunuar me Shumicë.
2. ARRU lëshon Licencë të re të Shërbimit, me nr. L-04/2/2026, e cila ndryshon dhe plotëson licencën ekzistuese L-04/2018 të KRU “Gjakova” Sh.A. të datës 25.09.2018, dhe e cila është e vlefshme deri më 10.09.2026, në përputhje me afatin e licencës paraprake.
3. KRU “Gjakova” obligohet që shërbimet nga Kategorija C dhe Kategorija E t’i ofrojë në përputhje me kushtet e licencës së shërbimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Licenca e Shërbimit me nr. L-04/2/2026, e ndryshuar dhe e plotësuar, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbën pjesë përbërëse të tij.

A R S Y E T I M

KRU “Gjakova” Sh.A. ka paraqitur kërkesën nr.28/01 datë 22.01.2026 pranë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për ndryshimin dhe plotësimin e licencës së saj ekzistuese të shërbimit, me qëllim të shtimit të dy kategorive të reja të shërbimeve të ujit, përkatësisht Kategorisë C – Shërbimet e Ujërave të Ndotura dhe Kategorisë E – Shërbimet e Ujit të Përpunuar me Shumicë.

ARRU, në përputhje me kompetencat e tij ligjore të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-042, ka shqyrtuar kërkesën, duke vlerësuar përmbushjen e kriterëve ligjore dhe rregullative për shtimin e këtyre shërbimeve në kuadër të licencës së shërbimit.

Gjatë shqyrtimit është konstatuar se kërkesa nuk ka të bëjë me ndryshimin e zonës së shërbimit, por me zgjerimin e fushëveprimit të licencës ekzistuese përmes shtimit të shërbimeve të reja, gjë që lejohet shprehimisht sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për

Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, i cili parasheh ndryshimin dhe plotësimin e licencës së shërbimit në raste të tilla.

Po ashtu, është vlerësuar se KRU “Gjakova” Sh.A. ka dëshmuar kapacitete adekuate profesionale, teknike, operacionale dhe financiare për ofrimin e shërbimeve të reja, si dhe zotim për zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi dhe kushteve të licencës së shërbimit.

Në këtë kontekst, ARRU ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për lëshimin e licencës së re të shërbimit, e cila ndryshon dhe plotëson licencën ekzistuese me nr. L-04/2018 të datës 25.09.2018, duke përfshirë edhe kategoritë e reja të shërbimeve të ujit.

Për arsyet e cekura më lartë, u vendos, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- KRU “Gjakova”;
- Të gjitha Departamenteve të ARRU;
- Njesisë për Inspektim.

Drejtori i ARRU

Hajrije MORINA

